



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Prishtinë: 23.03.2023
Kodi i ZRRE-së: V_1682_2023

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Dëshmitë e paraqitura nga palët; dhe
- Rekomandimin e DMK-së të ZRRE-së: ZRRE/DMK_R_2411_02_23.

në seancën e mbajtur më datë 23.03.2023 nxori këtë:

V E N D I M

- **REFUZOHET** ankesa e konsumatorit **Trepça SH.A** nga Komuna e Mitrovices si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij rekomandimi

A r s y e t i m

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK-së në ZRRE me datë 19.12.2022 ka apeluar përgjigjen e KESCO-s –Departamenti për Konsumatorë të datës 07.12.2022 për shkak të mos dhënies së pëlqimit për kyçje në rrjetin e KEDS në nivelin 10 kV.

- Me datë 29.09.2022 konsumatori **Trepça Sh.A** ka bërë kërkesë zyrtare në KESCO për kyçje në rrjetin e Shpërndarjes-KEDS në nivelin 10kV, përkatësisht në linjën e furnizimit me tension 10kV përkatësisht në largpërçuesin e Shalës. Në kërkesën e konsumatorit është specifikuar se kjo kyçje nevojitet vetëm për nevojën urgjente të aktivizimit të ashensorit, për nxjerrjen e minatorëve nga miniera e Stantërgut dhe atë vetëm për rastet kur kemi rënie të furnizimit me energji elektrike nga largpërçuesi 35 kV. Në kërkesë po ashtu është specifikuar se aplikuesi do të instalojë një trafo të fuqisë 2.5 MVA, për minierën e Stantërgut e cila do të shërbejë vetëm për rastet emergjente të aktivizimit të ashensorit për nxjerrjen e minatorëve nga miniera e Stantërgut, prandaj kërkohet mundësinë e lidhjes në largpërçuesin e Shalës 10 kV, për shfrytëzim emergjent.
Provë: Kërkesa e konsumatorit datë 29.09.2022
- Me datë 07.12.2022 Departamenti për Konsumator në KESCO i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar për kohësisht kërkesën e konsumatorit për kyçje bazuar në pamundësinë teknike të kyçjes së përkatësisht pasi që OSSH nuk ka në pronësi të rrjetit të furnizimit prej 110 kV si dhe që deri më tani për shkak të sigurisë nuk ka dhënë leje për kyçje nga dy alternativa (linja) për të njëjtën pronë/objekt. Në përgjigjen e KESCO-s theksohet po ashtu se nënstationi i cili ka ekzistuar në këtë pjesë e i cili për një kohë të gjatë ka qenë i kyçur nga NS i juaj tani nuk ekziston pasi që i gjithë rrjeti i tensionit të mesëm është transferuar në 10/20 kV me transformim nga niveli 110 kV nga operatori i transmisionit KOSTT.
Provë: Përgjigja e KESCO-s e datës 07.12.2022



- Me datë 19.12.2022 konsumatori ka parashtruar ankesë në DMK të ZRRE-së duke kundërshtuar përgjigjën e lëshuar nga KESCO(KEDS) si dhe ka kërkuar ti mundësohet kyçja ne linjën ekzistuese nivelin e tensionit 10 kV drejtimi i Shalës.
Provë: Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së datë 24.02.2022

Bordi i ZRRE-së duke analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e konsumatorit dhe KEDS/KESCO, ka vërejtur se:

Me datë 29.09.2022 konsumatori **Trepça Sh.A** ka bere kërkesë zyrtare ne KESCO per kyç jen e tij ne rrjetin e Shpërndarjes-KEDS ne nivelin 10kV, përkatësisht ne linjën e furnizimit me tension 10kV përkatësisht ne largpërçuesin e Shalës. Ne kërkesën e konsumatorit është specifikuar se kjo kyçje nevojitet vetëm per nevoja urgjente te aktivizimit te ashensorit, per nxjerrjen e minatorëve nga miniera e Stantërgut dhe atë vetëm per rastet kur kemi rënie te furnizimit me energji elektrike nga largpërçuesi 35 kV. Ne kërkesë po ashtu është specifikuar se do te instaloj një trafo te fuqisë 2.5 MVA, për minierën e Stantërgut e cila do te shërbejë vetëm per rastet emergjente te aktivizimit te ashensorit per nxjerrjen e minatorëve nga miniera e Stantërgut. Prandaj kërkojmë mundësin e lidhjes ne largpërçuesin e Shalës 10 kV, per shfrytëzim emergjent.

Me datë 07.12.2022 Departamenti për Konsumator në KESCO bazuar ne udhëzimet e Operatorit te Shpërndarjes (KEDS), i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar përkohësisht kërkesën e konsumatorit per kyçje ne rrjetin 10 kV per shkak te pamundësisë teknike te kyçjes - përkatësisht mungesës se rrjetit 10 kV si dhe stabilimenteve distributive. Ne përgjigjën e lëshuar nga KESCO theksohet se: pas daljes dhe inspektimit ne teren si dhe shtrirjes gjeografike te rrjetit te KEDS-it është konstatuar se, objekti i juaj veç se furnizohet nga një pike tjetër nga niveli 110 kV. Duke u thirrur ne kërkesën e konsumatorit/aplikuesit per siguri ne furnizim, KESCO ka informuar konsumatorin se KEDS asnjëherë nuk ka dhënë leje per kyçje nga dy linja per te njëjtën pronë/kompani/objekt e aq me tepër ne nivele te ndryshme te kyçjes/tensionit dhe se nuk ka rregullim ligjor per shqyrtimin e tyre. Ne vazhdimësi te përgjigjes, KESCO ka arsyetuar se nënstationi i cili ka ekzistuar ne këtë pjese e i cili per një kohe te gjatë ka qenë i kyçur nga NS i juaj tani nuk ekziston pasi qe i gjithë rrjeti i tensionit te mesëm është transferuar ne 10/20 kV me transformim nga niveli 110 kV nga operatori i transmisionit KOSTT. KESCO ne përgjigje thekson po ashtu se, duke pasur parasysh se konsumatori furnizohet përmes linjës se KOSTT 110 kV, çfarëdo lidhje tjetër alternative per furnizim me energji elektrike bie ne kundërshtim me Kodin e Rrjetit duke pasur parasysh se i njëjti objekt nuk mund te furnizohet nga dy kyçje alternative per shkaqe te sigurisë së rrjetit te shpërndarjes dhe operimit te punëtorëve ne teren.

DMK ka analizuar me kujdes përgjigjën e KESCO e lëshuar bazuar ne udhëzimet e Operatorit te Shpërndarjes (KEDS) per konsumatorin **Trepça Sh.A** lidhur me kërkesën per kyçje ne rrjetin 10kV largpërçuesin e Shalës, dhe konstaton se bazuar ne te dhënat e evidentuara ne përgjigje, konsumatori **Trepça Sh.A** është i kyçur ne nivelin e Tensionit te Lartë 110 kV bazuar edhe ne kapacitetin instalues/kërkesës se tij, prej nga edhe behet furnizimi dhe matja e shpenzimeve energji elektrike, si dhe ka marrëveshjen e kyçje s të nënshkruar me Operatorin e Sistemit te Transmisionit dhe Tregut (KOSTT). Po ashtu KEDS ka dëshmuar se nuk ka kushte teknike per furnizim pasi qe nënstationi i cili ka ekzistuar ne këtë pjese e i cili per një kohe te gjatë ka qenë i kyçur nga NS **Trepça Sh.A** tani me nuk ekziston pasi qe i gjithë rrjeti i tensionit te mesëm është transferuar ne 10/20 kV me transformim nga 110 kV nga operatori i transmisionit KOSTT.



Refuzimi i qasjes së palës së tretë në rrjetin e Shpërndarjes apo edhe të Transmisionit mund të bëhet vetëm në rastet kur nuk ka mundësi teknike të kycjeve dhe kjo është rregulluar me Ligjin për Energjinë elektrike (Ligj.NR.5/L-085) nën 45 përkatësisht paragrafi 1 e ku thuhet se: ***“Operatori i Sistemit të Transmetimit apo Operatori i Sistemit të Shpërndarjes mund të refuzojnë qasjen në sistemin e transmetimit apo të shpërndarjes nëse nuk ka në dispozicion kapacitete të nevojshme, dhe nëse mungesa e kapaciteteve arsyetohet në mënyrë objektive në bazë të kriterëve të arsyeshme teknike, duke pasur parasysh sigurinë e furnizimit, ose cilësisë së furnizimit, duke marrë parasysh standardet e shërbimit dhe besueshmërinë e kërkuar nga personi që kërkon qasje, si dhe të gjitha kodet dhe rregullat në fuqi”***, kurse nën 51 paragrafi 4 i këtij ligji përcakton rastet kur operatori i sistemit mund ta refuzojë përkohësisht kycjen e një aplikuesi e ku thuhet se: ***“Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes mund ta refuzojë përkohësisht kycjen e një konsumatori ose prodhuesi në sistem, nëse konstaton se pajisjet e konsumatorit apo të prodhuesit nuk plotësojnë normat teknike ose kushtet tjera të përshkruara në Kodin e rrjetit të transmetimit dhe Kodin e rrjetit të shpërndarjes”***.

Po ashtu në nën 5 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji elektrike është rregulluar drejta e konsumatorëve për kycje, e ku thuhet se: ***“Të gjithë konsumatorët kanë të drejtën që të kërkojnë kycje të objekteve dhe pajisjeve të tyre energjetike në rrjetin e operatorit të sistemit, nëse një kycje e tillë është teknikisht e mundur, sipas dispozitave të Kodit të Rrjetit ose Shpërndarjes, ndonjë kod ose Rregulle tjetër në fuqi”***.

Kurse nën 10 paragrafi 1 dhe 3 i Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji elektrike përcakton rastet kur operatori i sistemit mund ta refuzojë përkohësisht kycjen e një aplikuesi e ku thuhet se: ***1. “Operatori i Sistemit mund të refuzojë kycjen e një aplikuesi përkohësisht, vetëm nëse ajo kycje nuk është në përputhje me dispozitat e Kodit të Rrjetit dhe Shpërndarjes ose kodeve tjera në fuqi”, dhe 3. “Operatori i sistemit do të refuzojë kycjen e një aplikuesi në rast se nuk ka kapacitetet të mjaftueshëm të rrjetit, por nuk do të refuzojë një kycje për një aplikues mbi bazën që nuk ka gjenerim të mjaftueshëm të lidhur me rrjetin”***.

Po ashtu ligjet primare të sektorit të energjisë, kodet teknike si dhe rregullat e nxjerra nga ZRRE nuk e përcaktojnë si mundësi furnizimin alternativ të konsumatorit të njëjtë në dy nivele të ndryshme tensioni, pra të gjithë konsumatorët kanë një numër unik identifikues e të cilët furnizohen nga një operatore i vetëm sistemit, transmisionit apo edhe shpërndarjes me të cilët duhet të ketë edhe marrëveshje të kycjes e që në rastin e konsumatorit Trepça Sh.A i njëjti ka marrëveshje të nënshkruar me KOSTT ku është e definuar se: Pika e kycjeve për Trepça Sh.A me kapacitet të kycjeve prej XMVA(2x63 MVA dhe 2x31.5 MVA), është në nivelin e tensionit 110 kV, përkatësisht në linjat ekzistuese 110 kV, LP 125/2(nr. i ri L109) dhe LP 125/3(nr. i ri L 110).

Bordi i ZRRE duke pasur parasysh të gjitha faktet e përmendura më lartë, dëshmitë dhe argumenteve të paraqitura nga palët e në veçanti që konsumatori është i kycur në nivelin e tensionit 110 kV nga ku edhe bëhet furnizimi me energji elektrike, pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.




Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:


Ymer Fejzullahu, Kryesues


Lutfije Dervishi, anëtare


Gani Buçaj, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Konsumatori: TREPÇA SH.A
- KESCO-së dhe
- Arkivit të ZRRE-së.